



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
-AUTORITETI I KONKURENCËS-

NJOFTIM PARAPRAK PËRQËNDRIMI

(Rasti Delta Maxi d.o.o— Euro Max Shpk)

Në datën 28 Maj 2008, Autoriteti i Konkurrencës ka marrë njoftimin e përqendrimit të propozuar në përputhje me nenin 10, pika 1, shkronja b të Ligjit Nr.9121, datë 28.07.2003 “Për Mbrojtjen e Konkurrencës”, sipas të cilit shoqëria Delta Maxi d.o.o me seli në Beograd, Serbi, përfton kontroll të plotë, nëpërmjet blerjes së veprimtarisë së tregtimit me pakicë të realizuar nga rrjeti i supermarketeve të shoqërisë Euro Max Shpk, me seli në Tiranë, Shqipëri.

1. Veprimtaria e palëve pjesëmarrëse është:

- **Shoqëria Euromax SHPK**, me seli në Tiranë, Shqipëri, në cilësinë e shitësit, është themeluar dhe funksionon sipas legjislacionit shqiptar. Objekti i veprimtarisë së saj është import-eksport dhe tregëtim i artikujve të ndryshëm ushqimorë dhe industriale, lëndëve të para për industrinë, materiale ndërtimi e hidrosanitare, paisje zyrash dhe kancelari.
Veprimtaria e tregtimit të shoqërisë Euromax Shpk realizohet nëpërmjet rrjetit të 17 supermarketeve të vendosura në Tiranë, Durrës, Elbasan dhe Fier.
- **Shoqëria Delta Maxi d.o.o.**, në cilësinë e blerësit është një shoqëri me përgjegjësi të kufizuar, e themeluar sipas legjislacionit serb, me seli në Beograd, Serbi. Veprimtaria e saj është tregëtia me pakicë kryesisht, ushqime dhe cigare nëpërmjet rrjetit të supermarketeve të saj në Serbi, Bosnje, Mal i Zi dhe Bullgari.
Delta Maxi, është pjesë e grupit me të njëjtin emër, Delta Max Gruop. Shoqëria Delta Maxi d.o.o., nuk është e pranishme në tregun e Republikës së Shqipërisë.

2. Nga shqyrtimi paraparak, Autoriteti gjeti që transaksioni i njoftuar është në përputhje me nenin 10 dhe 12 të Ligjit. Palët pjesëmarrëse veprojnë në të njëjtin nivel tregu të produktit (kanë marrëdhënie horizontale), por në tregje gjeografike të veçanta dhe nuk kanë klientë të përbashkët. Ky transaksion që sjell një përqendrim në

tregun e tregimit me pakicë nëpërmjet rrjetit të supermarketeve, do t'i nënshtrohet procedurës së kontrollit të përqendrimeve të përcaktuar në nenin 56 të Ligjit dhe në Rregulloren "Për Zbatimin e Procedurave të Përqendrimit të Ndërmarrjeve".

3. Autoriteti fton palët e treta për të shprehur opinionet e tyre për transaksionin e njoftuar.

Opinionet duhet të paraqiten jo më vonë se 15 ditë nga publikimi i këtij njoftimi.

Opinionet mund të dërgohen pranë Autoritetit të Konkurrencës me fax 00355 42 234 497, me postë në adresën: Autoriteti i Konkurrencës, Rr "Sami Frashëri", Nr 4 Tiranë; apo me e-mail në adresën competition@caa.gov.al.